



**VENDIM**

**Nr. 91 Datë 26.09.2011**

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË “ERALD ENERGJITIK” SH.P.K  
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTIRIKE  
NGA HEC-ET “SHEMRI” DHE “MGULLE”**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 gërma “a”, 9, 13 pika 1, gërma “a” dhe 15 pika 3 të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, gërma “a”, 13 dhe 14 pika 1 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.09.2011, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ERALD ENERGJITIK” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “ERALD ENERGJITIK” sh.p.k plotëson përgjithësisht kërkesat e parashikura nga ERE në rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshem dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni finaciari dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Kërkesa që ka të bëjë me Lejet nga institucionet e tjera (Pika e lidhjes nga Rrjeti i Shpërndarjes; neni 9 pika 4.1.5), rezulton në proces realizimi.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “ERALD ENER GjITIK” sh.p.k, në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga Hec-et: “Shemri” me fuqi 1 MW dhe “Mgulle” me fuqi 0.28 MW, për një afat 30 vjeçar, me kusht që:
  - Shoqëria “Erald Energjitik, të dorëzojë “Miratimin e Pikës së Lidhjes me Sistemin e Shpërndarjes”, brenda 90 ditëve nga data e miratimit të licensës.
1. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.